



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
DREJTORIA E PROVIMEVE TË SHTETIT

N J O F T I M

**PËR TESTIMIN E INFORMATIZUAR TË MATURANTËVE NË KUADËR TË PRANIMIT
NË PROGRAMIN MJEKËSI E PËRGJITHSHME NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË**

Për të gjithë maturantët aplikantë për pjesëmarrje në testimin e informatizuar në kuadër të pranimi në programin e studimit “Mjekësi e Përgjithshme” në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, ju bëjmë me dije se aplikimi do të kryhet vetëm online nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania, gjatë periudhës **11 – 13 Gusht 2025**, duke ndjekur hapat, si më poshtë:

- Identifikohuni si qytetar në portalin e-Albania;
- Zgjidhni shërbimin “Aplikim për provimin e pranimi në programin “Mjekësi e Përgjithshme””;
- Në formularin që ngarkohet, plotësoni të dhënat e nevojshme për regjistrimin në provimin e pranimi në programin “Mjekësi e Përgjithshme”;
- Ngarkoni mandat pagesën.

Faturën për arkëtim për kryerjen e pagesës mund ta shkarkoni në faqen zyrtare të QSHA www.qsha.gov.al, në linkun: <https://qsha.gov.al/wp-content/uploads/2025/02/Fature-e-arketimit-te-tarifesh-per-kandidatet-qe-japin-provimet-e-tjera-te-digjitalizuara-prane-QSHA-se.pdf>

Maturantët do të njoftohen në çdo fazë të aplikimit nëpërmjet postës elektronike si dhe portalit qeveritar e-Albania në rubrikën Hapësira ime – Mesazhet e mia dhe me anë të kodit unik të gjurmimit do të mund të gjurmojnë në çdo kohë statusin e aplikimit.

Testimi i informatizuar do të zhvillohet pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA), me adresë: Bulevardi “Zhan D’Ark”, Nr. 23, Tiranë (ish-ATSH), pas datës **15.08.2025**.

Ditën e zhvillimit të testimit të informatizuar, maturantët duhet të kenë parasysh:

- të jenë të pajisur me dokument identifikimi (kartë identiteti ose pasaportë);
- të paraqiten së paku 30 minuta përpara fillimit të testimit;
- ndalohet mbajtja dhe përdorimi i celularëve apo mjeteve të tjera të komunikimit gjatë zhvillimit të testimit, pasi kjo vlerësohet si kriter mos kualifikimi;
- ndalohet komunikimi me kandidatët e tjerë gjatë zhvillimit të testimit deri në marrjen e deklaratës së rezultatit;
- ndalohet lëvizja përtej vendit të përcaktuar për zhvillimin e testimit;
- firmos deklaratën e rezultatit të marrë.

Kalendari i organizimit të testimit dhe orari i pjesëmarrjes në testim për çdo maturant, do të publikohen në vijim në faqen zyrtare të Qendrës së Shërbimeve Arsimore www.qsha.gov.al.

Orari i pjesëmarrjes në testim do të jetë i përcaktuar dhe nuk do të mund të ketë ndryshime.

Ju urojmë suksese!